



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Podujevë, 15 Dhjetorë 2021

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Për Takimet e Kulturës “Kadri Kadriu” 2021

SHPALL

KONKURS LETRAR
Për
POEZI, ESE dhe TREGIM TË SHKURTËR

Takimet e kulturës “Kadri Kadriu” janë takime tradicionale të cilat mbahet edhe në këtë vit në Podujevë, mbahet edicioni i 39-të i këtij takimi, andaj inkurajohen krijues letrar nga të gjithë trevat shqiptare që me poezitë, ese-të dhe tregimet e shkurtëra të bëhen pjesë e këtij takimi letrar.

Qëllimi i konkursit

- Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i traditës kulturore
- Nxitja, motivimi dhe promovimi i krijësve shqiptarë.

Kushtet për pjesëmarrje

- Poezitë, ese-të dhe tregimi i shkurtër që konkurojnë duhet të jenë origjinale, çdo plagjiaturë do të s'kualifikohet.
- Poezitë, ese-të dhe tregimi i shkurtër nuk duhet të jenë më të gjatë se 56 vargje. Temë e lirë
- Punimet të jenë të punuara në: Microsoft Word, formati i shkronjave: Time New Roman, 12 (në tre kopje).
- Poezitë, ese-të dhe tregimi i shkurtër të jenë në gjuhën shqipe, të pabotuara më parë.
- Punimet ME SHIFER duhet të dorëzohen në Komunen e Podujevës, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, nr. 45, në zarfe të mbyllura.
- Afati i fundit për dorëzimin e tyre është 23 dhjetor.

- Punimet e konkursit do t'i vlersojë Juria profesionale.

Ndërsa për çmimin "Afrim Maliqi", juria do të vendos në
ORËN E MADHE LETRARE

Poezitë e arritura do të grumbullohen në dosje, pa të dhëna për autorët por vetëm me shifër. Punimet e paraqitura në konkurs do të vlerësohen nga juria profesionale e cila do të bëjë leximin dhe vlerësimin e poezive, pa pasur dijeni mbi autorët, por vetëm në bazë të shifrës. Juria do të përmbyllë procesin e vlerësimit para datës së mbajtjes së takimit, ndërsa ndarja e çmimeve do të bëhet në ditën e mbajtjes së Manifestimit.

Pjesëmarrësit poetë, shkrimtarë e krijues tjerë që do të marrin pjesë në ORËN LETRARE do të konkurojnë për çmimin "Afrim Maliqi", gjithashtu në Oren letrare do të lexohen edhe punimet fituese.

Në këtë takim letrar do të ndahen këto çmime:

- Çmimi vendi -I-
- Çmimi vendi -II-
- Çmimi vendi -III-

- ÇMIMI "Afrim Maliqi"

Si dhe çmimi "**Debutusi/ja**", i cili ndahet për poetin më të ri në moshë që merr pjesë për herë të parë në këtë takim.

**ORA E MADHE LETRARE MBAHET MË: 28.12.2021, NË ORËN: 14:00,
NË TEATRIN E QYTETIT "AVDUSH HASANI", NË PODUJEVË.**

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

